



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Nr. 01-111/01-13225
Gjakovë

Datë: 18.06.2020

Në bazë të nenit 16 të Ligjit numër 04/L-106 për Teatrot dhe Rregullores numër 05/2014 dhe 04/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve, Komuna e Gjakovës bën:

SHPALLJE E KONKURSIT PËR REKRUTIM

Njësia:	DKRS, Teatri i Qytetit "Hadi Shehu"
Titulli i vendit të punës:	Aktorë
Niveli i pagesës:	sipas koeficientit 7.0
Numri i ekzekutuesve:	6 (gjashtë)
Orari i punës:	i plotë, 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të mësojnë tekstin dhe të mbajnë prova;
- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të diskutojnë interpretimin dhe të shfaqin kreativitet;
- Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- Të performojnë drejtpërsëdrejti para publikut;
- Të përformojnë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit;
- Të kujdesen për hapësirën performuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të mbajnë në mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përpunim me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tyre i përgjigjen regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të teatrit.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare nga Fakulteti i Arteve, drejtimi i Aktrimit.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të kenë së paku 2 vite përvojë pune pas diplomimit në realizimin e roleve në Teatër;
- Të dëshmojnë talentin dhe përvojën e tij para audicionit që e organizon Komisioni profesional;

- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar (njohja e gjuhëve të huaja është përparësi);
- Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër njerëzore dhe të jenë të gatshëm të punojnë me orar fleksibil të punës.
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel);
- Përzgjedhja e aktorëve për ansamblin rezident bëhet përmes audicionit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Procesi i rekrutimit është i paraparë me Ligjin numër 04/L-106 për Teatrot dhe Rregulloret numër 05/2014 dhe 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve.

Kohëzgjatja e emërimit: Aktorët që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi vazhdimi sipas suksesit dhe angazhimit të treguar në harmoni me Rregulloret e sipër cekura.

Afati i konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjete (15) ditë kalendarike nga data e publikimit (nga 18.06.2020 deri 02.07.2020) në orën 16:00.

Dokumentet e kërkuara:

CV-ja, Diploma mbi kualifikimin e noterizuar, Diplomat e lëshuara nga Institucionet Shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje); Vërtetimi për përvojën e punës (kopje); Certifikata që nuk jeni nën hetime (origjinal); Dokumenti i identifikimit (kopje).

Dokumentet e pranuar nuk kthehen.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhes në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimi* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III*

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.
-Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.